



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 383, datë 02.10.2020**

**PËR**  
**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË**  
**NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR**  
**KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR TRE POZICIONET E LIRA,**  
**TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 88, NR. 89 DHE**  
**NR. 90, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “d”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Ilir Toska,

**VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, nr. 89 dhe nr. 90, datë 26.02.2020.
2. Vendimi nr. 207, datë 18.06.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**